


Bashkia Shijak



Raporti Performancës 2021



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2021 të bashkisë Shijak.

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Shijak me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe grupin Teknik të Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021	4
Burimet e Financimit	5
Shpenzimet buxhetore	6
Investimet	7
Administrimi i bashkisë	8
Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara.....	10
Furnizimi me ujë	11
Rrjeti rrugor rural	13
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	15
Menaxhimi i mbetjeve	17
Sport dhe argëtim	19

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshembull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021

Bashkia Shijak

Bashkia Shijak arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë ka pësuar rënie. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë biznet e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Shërbimet edhe pse nën ndikimin e rënies së volumit të xhiros duke u krahasuar me vitin 2020, kur pothuajse u mbyllën totalisht njësitë e bar-restoranteve, e rimorën disi veten në vitin 2021. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Në tërësi bizneset pësuan rënie në prodhim e shërbime e për rrjedhojë rënie e fitimit të cilat çuan në rënie e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore që mbledh bashkia. Gjë që u reflektua në totalin e të ardhurave të veta të bashkisë të cilat vazhdojnë të bien dhe ende nuk kanë arritur nivelin e vitit 2019. Bizneset në një masë të konsiderueshme ndaluan punën tërësisht ose përkohësisht për t'iu adaptuar kushteve të reja pandemike.

Një buxhet në rritje i bashkisë vjen për shkak të mbështetjes nga qeveria qendrore e cila ka rritur me rreth 52% kontributin e saj kundrejt vitit 2020 një kontribut cdo vit në rritje ky, kryesisht për shkak të projekteve të rindërtimit të banesave të komunitetit dhe institucioneve publike që u prishën nga tërmeti i dhjetorit 2019.

Është për t'u theksuar se edhe gjatë këtij viti bashkia ashtu sikurse në vitin e kaluar i ka ardhur në ndihmë familjeve të dëmtuara nga tërmeti të cilat kanë përfituar bonos (grant për qeranë e përkohshme) si edhe ndërtimin e banesave apo apartamenteve si financim nga qeveria qendrore nëpërmjet bashkisë.

Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:

- ✿ Rritja e investimeve duke kapur të një peshë mbi 43% në tërësinë e buxhetit të bashkisë
- ✿ Mbështetje me shërbime sociale duke zënë një peshë nga më të lartat në buxhetin e bashkisë
- ✿ Ruajtjen e numrit të personelit të bashkisë
- ✿ Rënia e peshës së të ardhurave të veta në totalin e burimeve të financimit të bashkisë duke mbetur asaj të para-Pandemisë.

Ekzekutimi i buxhetit ka arritur të përdorë të gjitha të burimet e financimit, duke arritur eficiencë në përdorimin e tyre në kohë sipas planifikimit buxhetor.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (Në mijë Lekë)		FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
		704,615	976,276	993,723	997,534	100%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2020	Fakt Vs Plan 2021 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	11,608	18,322	22,947	11,857	194%
	Të ardhura nga taksat lokale	129,687	104,574	99,900	166,224	60%
	Të ardhura nga tarifa vendore	20,844	28,396	31,037	39,511	79%
	Të ardhurat e tjera	2,665	4,878		13,346	0%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e kushtëzuar	277,122	356,074	598,678	512,378	117%
	Transferta e pakushtëzuar	130,451	134,908	147,139	147,139	100%
	Transferta specifike	61,948	62,815	94,022	67,079	140%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi nga viti i shkuar	20,000	40,000			





Figura 1. Pesha e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë ende modeste. Vazhdimi i pandemisë bëri që ardhurat nga burimet e veta të bien lehtësisht krahasuar me një vit më parë. Burimet e financimit u karakterizuan nga:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë u rritën me 2% kundrejt vitit 2020 pothuajse tërësisht sipas planit për vitin 2021
- ✿ Pesha e të ardhurave të veta (taksat dhe tarifat) në total burime financimi është 15% dhe transfertat e qeverisë është 85%
- ✿ Të ardhurat e veta ranë me 1%
- ✿ Të ardhurat e qeverisë u rritën me 52%
- ✿ Fondet e investimeve të financuara nga qeveria qendrore u rritën me 17%
- ✿ Realizimin më të ulët e kanë taskat dhe tarifat vendore kundrejt planit 2021

Shpenzimet buxhetore




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rënie kundrejt vitit 2020 me rreth 6%, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 74%. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore.

- ✿ *Furnizimi me ujë*
- ✿ *Kujdesi social për PAK*
- ✿ *Rrjeti rrugor*
- ✿ *Administrimi*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*
- ✿ *Menaxhimi i mbetjeve*
- ✿ *Sport dhe argëtim*

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (Në mijë Lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	148,410	412,984	371,577	444,488	84%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 371 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet kanë rënë me rreth 10%, Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2021 kundrejt planit është në masën 84%.


Investimet e bashkisë gjatë vitit 2020 kanë shënuar një hap cilësor në menaxhimin financiar:

- ✿ Investimet zënë në fund të vitit 2021 rreth 43% të buxhetit të bashkisë, një kontribut i rëndësishëm ky në totalin e buxhetit të bashkisë
- ✿ Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: infrastrukturës rrugore, rrjetin ujësjellës dhe të kanalizimeve të ujërave të zeza, rikonstruksionin e tubacionit kryesor në Gjepalaj, përmirësimin e kushteve në çerdhe dhe kopshte etj.

Administrimi i bashkisë

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	73,252	8,5%	65%

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik:



Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korente dhe investim

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↓	Numri i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	3.53	0.64	25.17	0
→	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numer kundrejt vitit të kaluar)	0	0	0	0
↑	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)		0.6	1.0	

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Ditë trajnimi në total		21	144	22
Numri total i personave të trajnuar		34	144	-

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	11	2	76	0
Femra			40	
Meshkuj			36	
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë			0	0
Numri total i punonjësve të bashkisë	312	312	302	312
Numri total i punonjësve në njesite shpenzuese	237	237	237	237
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	75	75	75	75
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë (në mijë lekë)	237	237	237	237
Shpenzime korente (në mijë lekë)	70,234	88,204	73,130	104,100
Shpenzime për investime (në mijë lekë)	11,643	175,032	122	7,966

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit


Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 65% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 8,5% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2020 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të përmetit dhe pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është përmirësuar respektimit i kuadrit ligjor dhe rregulloret e administratës. Nuk janë aplikuar masa disiplinore për punonjësit e bashkisë;
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratës. Janë ofruar trajnime edhe pse në kushte pandemie për personelin e bashkisë. Është për tu theksuar se 85% e personelit të trajnuar janë gra
- ✿ Është rritur numri i personave që kanë lëvizur nga puna duke ulur qëndrueshmërinë e administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Administrimi i bashkisë	11,643	175,032	122	7,966	0%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Asistence teknike per pasuri e paluajtshme ne funksion te ligjit 7501 dhe rregjistri e i ne zona te vecanta			4,860	0	0%
Blerje PC dhe Kondicioner			1,966	0	0%
Ndertim Bashkie e re Shijak					
Rikonstruksion i Zyrave Gjepalaj	1,452				

Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	173,707	20%	93%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i kushteve të jetesës së personave të sëmurë dhe me aftësi të kufizuara. Rritja ose përmirësimi i skema / institucioneve që ofrojnë shërbime për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Perfitimi monetar për 1 person të sëmurë dhe PAK (mesatarisht në mijë lekë / person)	1,020	1,020	1,296	1,141
○	Persona të mbështetur me pagesë invaliditeti (Ndryshimi vjetor në numer)	10	4		
→	Persona me aftësi të kufizuara të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale (Ndryshimi vjetor në numer)	0	0	0	
↓	Numri shërbimeve të ofruara për persona PAK në shtëpi (Ndryshimi vjetor në numer)	-2	2	-2	

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti	163	163	134	163
Femra	71	74	57	74
Meshkuj	92	89	77	89
Numri i personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me pagesë PAK			488	
Numri i shërbimeve të ofruara për PAK-të në shtëpi-familje	0	2	0	2


Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzimet totale për mbështetjen e personave PAK (në mijë lekë)	166,246	166,246	173,707	186,000

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 99% kundrejt planit 2020. Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 20% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar si edhe rritur mbështetjen për personat e sëmurë dhe me afatësi të kufizuar:

- ✿ Më pak persona të mbështetur me pagesë invaliditeti
- ✿ Më shumë para mesatarisht në vit për person të mbështetur
- ✿ Është ulur numri i shërbimeve për personat që u bëhët shërbimi në shtëpi.

Furnizimi me ujë



Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korrente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Orë ujë në ditë (Ndryshimi vjetor në orë/ditë)	3.22	0.20	0.50	0
↑	Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzime korrente (në %)			15.72	
↑	Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (përfshirë investime dhe amortizimi) (në %)			238.30	

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	38,537	38,537	38,537	38,537
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm (mesatarisht orë në ditë)	8.8	9	9.5	9

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Popullsia totale e bashkisë	46,996	46,996	47,000	46,996
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm (në mijë lekë)			672	
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm (në mijë lekë)			4,274	
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi) në mijë lekë			282	

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përbalueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë në masën 99% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 33% të buxhetit të saj për ofrimin e ujit të pijshëm për komunitetin, pasi objektivi shumë i rëndësishëm i saj është shtimi i popullatës të cilës i ofrohet ujë i pijshëm dhe kanalizime sanitare. Aktualisht uji i pijshëm ofrohet nga UK Durrës ndërkohë që bashkia paguan ujin me shumicë nga kjo ndërmarrje publike. Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

- ✿ Ruajtjen e të njëjtit nivel të mbulimit me ujë të pijshëm të familjeve dhe bizneseve dhe vazhdimin e punës për të futur në skemën e furnizimit me këtë shërbim edhe të familieve që nuk e aksesojnë deri më sot. Investimet që janë duke u realizuar do ta përmirësojnë këtë tregues në vitet e ardhshme
- ✿ Rritja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët
- ✿ Mbulimi i kostos së prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nga tarifat e shërbimit.


Duke qenë se ky është një shërbim në zgjerim bashkia do të mbledhë dhe raportoje të dhëna për sa më sipër duke filluar që nga viti 2022.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Furnizimi me ujë	630	0	282,355	170,865	165%
Në mijë Leke					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Ndërtim i Rrjetit të Ujesjellesit në qytetin e Shijakut		70,866	211,635	211,600	100%
Ujesjellesi Likeshe	1,994				

Rip mirmbajtje rrjet Ujesjelles/ NjA Shijak	3,356			
Furnizimi me ujë				
Rikonstrukcion i tubacionit nga mbikalimi i Vores deri ne Depo Shijak "Rrjet shperndares te fshatrave Maminas, Karec, Bilalas, Karpen ,Bodinak Loti I "		70,720	70,720	100%
Ujesjellesi Likeshe	1,994			

Rrjeti rrugor rural

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	93,315	11%	33%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërlokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0	0	0
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	347	995	416	1,518
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mije Lekë për 1 km rrugë rurale		123	199	406
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mije Lekë për 1 km rrugë urbane		4,188		949
Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)		0		0
Raporti i rrugeve te asfaltuara ndaj totalit te rrugeve (te asfaltuara, cakull etj) ne %		16.56		16.56

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 33% të planit 2021 në një vlerë prej mbi 93 milionë Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 73% të tyre. Bashkia shpenzon rreth 11% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✿ Janë ulur aksidentet rrugore;
- ✿ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- ✿ Është rritur kosto mesatare e 1 km linear rrugë të mirëmbajtur, kjo për shkak të standardeve më të larta të rrugëve të shërbyera.

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	163	163	163	163
Rrugë rurale të mirëmbajtura	128	128	128	128
Rrugë urbane të mirëmbajtura	35	35	35	35
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	0	27	0	27
Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara	0	27	85	27
Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara	0	0	0	0


Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	163	163	163	163
Rrjeti rrugor rural	128	128	128	128
Rrjeti rrugor urban	35	35	35	35
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë Lekë	56,491	162,266	67,848	247,502
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin rural		15,680	25,467	52,000
Shpenzime për menaxhimin e rrjetin urban		146,586		33,208

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Rrjeti rrugor rural	26,665	134,166	67,848	217,421	31%
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Rruge te brendsh shijak sheshi Naim Frasheri			27,000	0	0%
Rikualifikimi rruges Ish SMT deri te Shala Group dhe ndertimi i rrjetit KUZ ne Rrugën " Xhelal Memoci		12,680	32,000	32,000	100%
Shpronësime publike	7,258		8,362	0	0%

Pjesemarrje ne investim 10 % rindertim i Shk " M. Dollaku "			6,300	200	3%
Rik. Sis. Asf rruga Auto Eminas i Vogel /NjA Gjepalaj					
Rik. Sis. Asf rruga Auto Cizmeli - Shetel /NjA Gjepalaj			50,961	0	0%
Rik. Sis. Asf rruga Auto KENETE/NjA Gjepalaj					
Rik. Sis. Asf rruga Lagje e re Metallaj/ NjA Maminas					
Rik. Sis. Asf rruga Lagje e re BODINAK/ NjA Maminas					
Rik. Sis. Asf rruga RRUBJEKE/ NjA Maminas			20,000	20,000	100%
Rik. Sis. Asf Lagjja e Keceve/ NjA Shijak			16,208	16,208	100%

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor



Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik



Qëllimi i programit buxhetor

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	40.10	28.54	7.94	35.27
→	Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	19.88	14.15	14.15	12.93
↓	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)	8,169	9,336	5,330	5,267

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor		48	48	
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	119	119	119	161
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	16	14	12	14

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjec	621	612	612	575
Mësues në sistemin parashkollor		22	40	22
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	2,366	1,684	1,684	2,081
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	59	59	212	59
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë (në mijë lekë)	130,706	130,706	63,961	73,736

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor si edhe pagesën e edukatoreve të kopshteve, dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 79% të planit 2021. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2020, ndërkohë që investimet e kryera përgjatë viteve të kaluara bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 8% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është ruajtur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Është ulur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues;
- ✿ Është ruajtur i njëjti nivel i kostos mesatare të një institucioni arsimor duke ruajtur eficiencën e përdorimit të parasë publike për këtë shërbim
- ✿ Investimet e realizuara përgjatë viteve si edhe ato në vitin 2020 synojnë përmirësimin e kushteve të punës së mësuesve dhe nxënësve. Investimet u realizuan në masën 12% të planit. Ku vlen të përmendet marrja në dorëzim e shkollës në Njësinë Administrative Xhafzotaj “Adem Sabli Borake”.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	63,009	59,361	1,598	13,450	12%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Ndërtim i Shkolles Adem Sabli Borake /NJA Xhafzotaj		52,211	664	660	100%
F.V Materiale per rrjetin e Ujesjelles Gjepalaj	1,080				
Rindërtim i Shkolles M Dollaku	28,031				
Pjesëmarrje ne investim 10 % rindërtim i Shk " Adem Sabli "			7,150	-	0%
Blerje paisje guzhina cerdhes			1200	938	78%

Menaxhimi i mbetjeve

	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
Realizimi faktik 2021	24,904	3%	60%




Figura 9: Kategoritë e shpenzimeve për programin Menaxhimi i mbetjeve korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i mjedisit duke mirëmenaxhuar mbetjet urbane për të mbrojtur shëndetin e popullatës dhe krijuar kushte më të mira për shëndetin e popullatës.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
➔	Raporti i Popullatës së mbuluar me shërbim kundrejt totalit të popullatës (në %)	93.22	93.22	93.22	93.22
➔	Raporti i territorit të mbuluar me shërbim kundrejt totalit të territorit (në %)	37.14	37.14	37.14	37.14



Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet dhe Nj.Administrative (Ndryshimi në herë në javë)	0	0	0	0
Raporti të ardhurave nga tarifa kundrejt faturimit të shërbimit (në %) – Norma e arkëtimit	31	55	61	76

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Popullsia e mbuluar me shërbim	31,225	31,225	31,225	31,225
Popullsia e mbuluar me shërbim në Qytet	7,568	7,568	7,568	7,568
Popullsia e mbuluar me shërbim në Njësitë administrative	23,657	23,657	23,657	23,657
Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (në km2)	64	64	64	64
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA) -në qytet dhe Nj.Administrative	4	4	4	4
Fekuenca në Qytet	6	6	6	6
Fekuenca në Njësitë administrative	2	2	2	2

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Popullsia totale nën administrimin e Bashkisë	46,996	46,996	47,502	46,996
Popullsia në Qytet	7,568	7,568	13,497	7,568
Popullsia në Njësitë administrative	39,428	39,428	34,005	39,428
Sipërfaqe totale e bashkisë (në km2)	92	92	92	92
Të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbetjeve (në mijë lekë)	13,302	22,876	16,887	31,282
Nga familjet	2,598	12,676	5,687	15,200
Nga bizneset	10,704	10,200	11,703	16,082
Buxheti për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	43,236	41,394	27,551	41,393


Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për grumbullimin, transferimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane në qytet dhe njësitë administrative si edhe pastrimin e rrugëve në pjesën urbane të bashkisë në masën 60% të planit buxhetor për vitin 2021. Bashkia shpenzon rreth 3% të buxhetit për këtë shërbim. Performanca e shërbimit tregon se:

- ✿ Është ruajtur frekuenca e tërheqjes së mbetjeve nga kazanat e grumbullimit që ka vendosur bashkia, 1 herë në ditë në zonën urbane dhe 2 herë në javë në zonën rurale;
- ✿ Bashkia aktualisht mbulon rreth 90% të popullatës me shërbim;
- ✿ Bashkia ka rritur grumbullimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit të pastrimit të qytetit duke arritur një normë arkëtimi në 61% nga 55% që ishte një vit më parë

Sport dhe argëtim

Realizimi faktik 2021	Vlera në mijë Lekë	Pesha ndaj totalit në %	Realizimi Faktik 2021
	24,540	3%	91%



Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i jetës aktive në komunitet nëpërmjet shtimit të eventeve sportive dhe hapësirave argëtuese

Figura 10: Kategoritë e shpenzimeve për programin Sport dhe argëtim: korente dhe investime

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
→	Metra katror hapësira çlodhëse dhe argëtuese (Ndryshimi vjetor në m2)	0	-1520	0	0
↓	Total shpenzime për veprimtarinë sportive kundrejt numrit total të banorëve rezidentë (Mijë leke/banor)	0.57	0.57	0.52	0.57
○	Të ardhura nga eventet sportive (Ndryshimi vjetor në %)	-51			
↑	Numri i biletave të shitura (Ndryshimi vjetor në %)	-68	-0.24	272.32	0

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Hapësira çlodhëse dhe argëtuese funksionale (në metra katrorë)	1,520			

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzime për mbështetjen e veprimtarive sportive (në mijë lekë)	26,822	26,822	24,540	26,982
Popullsia e bashkisë	46,996	46,996	46,996	46,996
Të ardhura nga eventet sportive (në mijë lekë)	131		221	221
Bileta të shitura në eventet sportive	420	419	1,560	1,560

Bashkia ka shpenzuar fonde për mirëmbajtjen dhe shtimin e hapësirave sportive dhe argëtuese në masën 91% të planit 2021. Bashkia alokon rreth 3% të buxhetit të saj për këto shërbime. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është ruajtur sipërfaqja e hapësirave që përdoren për evente sportive
- ✿ Është rritur numri i eventeve sportive të organizuara për rrjedhojë rritur numri i biletave të shitura
- ✿ Është ulur financimi i këtij shërbimi llogaritur për frymë në këtë bashki, kjo për shkak të prioriteteve të tjera që ka pasur buxheti i bashkisë në vitin 2021

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Sport dhe Argëtim					
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Rikonstrukcion i Stadiumit te Futbollit Shijak	1,670				
Ndertim i Pallatit te Sportit "Erzeni Arena" Shijak					